

MENDIM PAKICE

Unë, komisioner Lulzim Hamitaj, si anëtar i trupit gjykues, nuk pajtohem me vendimin e marrë nga kolegët e shumicës për të shkuar në vendimmarrje përfundimtare vetëm me një kriter të rivlerësimit, dhe rrjedhimisht shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Aleks Nikolli, për shkak se niveli i provueshmërisë në kriterin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas mendimit të pakicës, në momentin e mbylljes së hetimit administrativ dhe për më tepër pas prapësimeve të paraqitura nga subjekti, nuk arriti një nivel provueshmërie të mjaftueshëm në rivlerësimin e pasurisë, për të përmbyllur rivlerësimin e tij me një vendim përfundimtar vetëm mbi këtë kriter. Pra do të duhej të ishte rihapur hetimi administrativ edhe në lidhje me kriterin e figurës dhe të aftësive profesionale, - për të cilat ishte kryer një hetim i thelluar dhe mungonte vetëm kristalizimi i gjetjeve dhe njoftimi i tyre tek subjekti, - në mënyrë që vendimmarrja përfundimtare të ishte më e plotë dhe më e bazuar. Shkaqet konkrete të këtij qëndrimi të pakicës do të përshkruhen shkurtimisht në vijim.

- i. Së pari, lidhur me pikën 24 (faqe 4 – parag. II *Seanca dëgjimore*), nuk jam dakord me vendimin e shumicës, kam votuar kundër qëndrimit për të mos e rihapur hetimin administrativ, pas kërkesës së subjekti i rivlerësimit, në vijim të analizimit të parapësimeve dhe dokumentacionit të shumtë provues të paraqitur prej tij nga momenti i mbylljes së hetimit mbi një kriter deri në seancën dëgjimore.
- ii. Së dyti, sipas mendimit të pakicës, vendimi i shumicës për të mos e rihapur hetimin administrativ mbi dy kriteret e tjera dhe rrjedhimisht për të shkarkuar subjektin e rivlerësimit vetëm për kriterin e pasurisë, është i brishtë dhe i bazuar mbi disa vlerësime provash dhe përlllogaritje që nuk janë ndarë nga unë dhe që më poshtë po i paraqes në mënyrë të përmbledhur:
 - a. Lidhur me pikën 1.11 të vendimit (faqe 9), nuk jam dakord me shprehjen/vlerësimin: [...] *“Gjithashtu ka depozituar si dokumentacion provues ligjor për të ardhurat e përfituara në formën e kompensimit nga sistemi i sigurimeve, llogarinë bankare të L. N., në të cilën rezultojnë kreditimeve automatike (automated CR), pra, të hyra në shumën 8,582 GBP, për të cilat nuk identifikohet urdhëruesi i pagesave, por subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion provues nga institucionet angleze për të provuar përfitimin e kompensimeve nga sistemi i sigurimeve”* [...]. Këto të ardhura duhej të ishin marrë në konsideratë në analizën financiare si një burim i ligjshëm, për sa kohë përfitimi i tyre ishte më se i provuar nga dokumentacioni bankar, sikurse shkaku i përfitimit të tyre dhe gjithashtu këto të ardhura nuk u nënshtroheshin detyrimeve tatimore, për tipologjinë e tyre. Konkluzionin se ato nuk mund të konsiderohen të provuara, për sa kohë nuk është lëshuar ndonjë tjetër dokument nga autoritetet angleze, nuk e gjej të bazuar, pasi provat e dokumentuara mjaftonin për të përlllogaritur edhe këto të dhëna në analizën përkatëse;
 - b. Lidhur me pikën 1.12 të vendimit (faqe 10), mendoj se përlllogaritja e shpenzimeve jetike nuk është kryer në mënyrë proporcionale dhe të ekuilibruar, pasi është zgjedhur dhe aplikuar një e dhënë statistikore nga një faqe interneti (*link*), që i përlllogariste shpenzimet në një nivel më të lartë se një tjetër *link*, po zyrtar dhe i besueshëm (me eksperiencë më se gjashtëdhjetëvjeçare), - të cituar edhe nga subjekti, - dhe duke mos mbajtur në vëmendje edhe faktin se një familje emigrantësh, mesatarisht, mund të shpenzojë disi më pak se shtetasit anglezë. Pra, marrja në konsideratë e të dhënave statistikore alternative, gjithmonë të bazuara mbi një *link* zyrtar, serioz e të besueshëm, do të sillte një rezultat më pozitiv në analizat financiare të kryera për vëllëzërit e subjektit. Kjo edhe për faktin se shumica nuk ka dhënë argumente bindëse se përse midis dy alternativave është marrë në konsideratë një e dhënë rënduese dhe një tjetër

e dhënë statistikore, që ndoshta përkon më shumë me realitetin, - për sa kohë të dyja të dhënat vijnë nga burime të besueshme, dhe në dyshim dhe në mungesë të provës së kundërt për sa ka pretenduar subjekti, interpretimi/zgjedhja e *link*-ut të aplikueshëm mund të shkonte në mosrëndimin e situatës financiare të personave të tjerë të lidhur.

- c. Lidhur me pikat 1.12.1 – 1.13 të vendimit (faqet 11-13), mendoj se naliza është e pabazuar dhe rënduese e pozicionit të subjektit përllogaritja e (aforfe) e shpenzimeve të ndërtimit për të gjithë ndërtesën ***katëshe, ndërkohë që analiza financiare duhej të ishte bërë vetëm për një kat (pra 1/3), aq sa ka përfituar konkretisht subjekti, pa kryer analizë edhe për investimet e kryera nga vëllezërit e subjektit për veten e tyre. Ndonëse fillimisht kjo qasje hetimore dukej në përputhje me të dhënat e konstatuara, por në konkluzion, duke mbajtur në vëmendje edhe shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerësimi i burimeve financiare duhej të kryhej vetëm për pjesën takuese të përfituar realisht nga subjekti (1/3, pra, një kat) dhe jo për të gjithë ndërtimin, që nuk i përket atij. Ky vlerësim i pakicës arrihet bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (shih vendimet nr. 4 dhe 7 të vitit 2020), duke e raportuar qëndrimin e Kolegjit me analizën dhe vlerësimin në këtë këndvështrim edhe të këtyre fakteve:

- (i) ndërtimi është kryer përpara se subjekti të fillonte detyrën (me përjashtim të shumës një milion lekë, të pohuar si investim i mëpasshëm dhe me të drejtë të futur në analizë si shpenzim);
- (ii) ndonëse në prezencën e një konfuzioni mbi dokumentacionin pasuror, edhe për shkak të mungesës së vëllezërve në Shqipëri, disa shpjegime të subjektit mbi kryerjen e veprimeve procedurale nga ai, por edhe për llogari të vëllezërve, si dhe mbi investimet financiare të kryera vetëm nga këta të fundit, mund të konsiderohen të besueshme, nisur nga marrëdhënia e veçantë midis tyre dhe zakonet mbi bashkëpunimin vëllazëror;
- (iii) deklaratimet ndër vite me konsistencë të subjektit se nuk ka kryer shpenzime/investime për këtë pasuri, por vetëm ka kontribuar duke ndjekur praktikatat përkatëse, nga leja e ndërtimit e më pas;
- (iv) pasi është përfunduar ndërtimi dhe mundësuar përdorimi i ndërtesës në fjalë, ajo është ndarë midis vëllezërve dhe rezulton e provuar se subjekti *de facto* ka disponuar dhe gëzon vetëm një kat, pra 1/3 e kësaj pasurie, dhe jo të tërën apo gjysmën (përpos pasaktësive apo konfuzionit formal, të cilat mund të lexohen nën dritën e marrëdhënies së veçantë). Në këtë rast, pasuria e përfituar nga subjekti do të rezultonte e krijuar me burime të ligjshme. Për rrjedhojë, qëndrimi i shumicës lidhur me këtë pikë vlerësohet joproporcional dhe jo në përputhje me faktet, si dhe në kundërshtim me orientimin e Kolegjit, dhe passjell rëndimin e pozitës të subjektit, duke e bërë atë përgjegjës edhe për burimet e përdorura për ndërtimin e pjesës së banesës që nuk bën pjesë në sferën pasurore të familjes së tij, - por të vëllezërve të tij emigrantë, dhe të krijuar përpara emërimit në detyrë të subjektit.

- iii. Lidhur me pikën 1.18 të vendimit (faqe 21-23), duke mbajtur në vëmendje edhe sa është shprehur në pikën e mësipërme, nuk jam dakord mbi moskonsiderimin e disa zërave të të ardhurave të vëllezërve të subjektit, sikurse ka pretenduar edhe subjekti, dhe konkretisht: i) remitancat financiare të provuara nga transfertat bakare dhe të deklaruara/depozituara në llogari apo depozita në Shqipëri – edhe përpara se subjekti të emërohej në detyrë; ii) përllogaritja e kursit të këmbimit sipas shpjegimeve të subjektit, për sa kohë Komisioni nuk ka provën e kundërt, lidhur me momentin e saktë të kryerjes së këmbimeve; iii) rezulton rënduese qasja nga njëra anë e mospërllogaritjes si të ardhura shumë e derdhura me sistem bankar, që

rezultojnë kreditime automatike (*automated CR*), pra, të futura në disponibilitet në rrugë e me burim ligjor *de facto* në shumën 8,582 GBP dhe nga ana tjetër përlllogaritja edhe e shpenzimeve jetike maksimale. Pra, së paku, mund të konsideroheshin si të kompensuara/zeruara shpenzimet jetike, përgjatë periudhës për të cilën kanë rezultuar transferimet bankare nga institucionet e shtetit anglez në llogaritë e personave të tjerë të lidhur.

- iv. Lidhur me pikën 5 dhe konkluzionet respektive të vendimit (faqe 31-38), nuk ndaj të njëjtin mendim në mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të burimeve financiare dhe jam kundër konkludimit për mungesë burimesh dhe, aq më tepër, nuk bie dakord mbi ekzistencën e ndonjë deklarimi të rremë apo të fshehjes së pasurisë. Ky qëndrim pakice bazohet në faktet që: burimi prej 3,2 milionë lekësh, i përfituar nga shitja e një njësie tregtare (të trajtuar në pikën 9 të vendimit – nuk bie dakord me konkluzione të kësaj pike në faqen 75.), duhet të konsiderohej në analizën financiare, për sa kohë është e provuar se kjo e ardhur është tatuar dhe rrjedh nga një kontratë noteriale, përpos dyshimeve të arsyeshme mbi një fiktivitet në çmimin e shitblerjes në fjalë. Fiktivitei i dyshuar mund të shkaktojë vlerësime negative lidhur me etikën e subjektit, por nuk mund të passjellë moskonsiderimin e një të ardhure të provuar në mënyrë të plotë dhe të tatuar, për rrjedhojë pasuria e trajtuar e në pikën 5 do të rezultonte e krijuar me burime të ligjshme financiare.
- v. Lidhur me analizën financiare të kryer për familjen e subjektit të rivlerësimit nuk bie dakord, pasi, duke iu referuar sa më lart kam shprehur: i) ajo bazohet mbi të dhëna që përfshijnë edhe shpenzimet e personave të tjerë të lidhur; ii) disa të ardhura dhe disa shpenzime nuk janë parë nën dritën e jurisprudencës dhe të proporcionalitetit të detyrimit provues të subjektit; iii) nuk janë konsideruar të ardhura të provuara nga kontrata e shitjes dhe të tatuara.
- vi. **Nga sa më lart, pakica arrin në përfundimin se, nëse vlerësimet do të ishin kryer duke mbajtur në vëmendje qëndrimin e Kolegjit dhe të pakicës, pamjaftueshmëria e mundshme financiare e familjes së subjektit, si dhe pasaktësitë e deklarimeve, të përshkruara dhe të argumentuara edhe nga shumica në këtë vendim, nuk janë me një peshë specifike të tillë, që të krijojnë bindjen se ato në vetvete mund të përbëjnë shkak për të insistuar edhe pas seancës dëgjimore në përfundimin e procesit me vendim përfundimtar vetëm mbi një kriter, pasi ky qëndrim, në këndvështrimin tim, ka hequr mundësinë e një vendimmarrjeje mbi të tria kriteret, duke e vlerësuar në tërësi këtë proces, dhe jo në raport të drejtë me faktet e provuara dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit. Kjo nuk do të thotë që pozicionimi im nuk do të mund të ishte për të njëjtin vendim përfundimtar, por kjo mund të realizohej nëpërmjet një vlerësimi më të gjerë dhe më të bazuar, duke mbajtur në konsideratë dhe vlerësuar edhe në elementet e gjetjeve të dy kriterëve të tjera.**

PËR KËTO ARSYE,

Unë, si anëtar në pakicë, vlerësoj se vendimi i shumicës së trupit gjykues, për të përfunduar procesin e rivlerësimit të subjektit Aleks Nikolli vetëm mbi një kriter, nuk është i drejtë, pasi çmoj se do të duhej të rihapej hetimi edhe për dy kriteret e tjera dhe të arrihej rrjedhimisht në një vendim më të bazuar.

**Anëtar në pakicë/kundër
Lulzim Hamitaj**